



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 495/3 Prot.

Tiranë, më 27.04.2023

V E N D I M

Nr. 64, Datë 27.04.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 60, datë 18.04.2023, të paraqitur nga z. E.H kundër Shoqërisë Bankers Petroleum Albania LTD, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Ka filluar punë në datë 15.07.2020 në detyrën “Investigator Sigurie” pranë Shoqërisë Bankers Petroleum. Me anë të shkresës nr. 1013, datë 05.11.2020 të Shoqërisë Bankers, njoftohet që të paraqitet për takim në datë 10.11.2020, për të diskutuar mbi çështje që lidhen me marrëdhënien e punës me shoqërinë. Me datë 10.11.2020 është zhvilluar takimi mes Bankers Petroleum dhe E.H. Në këtë takim është mbajtur procesverbali i takimit nr. 1013/1, datë 10.11.2020. Me shkresën nr. 1013/2, datë 13.11.2020 “Njoftim për zgjidhje përfundimtare të kontratës së punës”, është bërë zgjidhja në mënyrë përfundimtare e kontratës së punës të lidhur mes palëve me datë 15.07.2020 dhe marrëdhëniet efektive të punës sipas kësaj shkrese do të përfundonin në datë 30.11.2020. Si shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në këtë njoftim është shënuar “për arsye të

¹ Për shkak të denoncimeve të bëra prej tij, për veprime korruptive të punonjësve të lartë të Shoqërisë Bankers Petroleum.

ndryshimit të strukturës organizative të Departamentit të Sigurisë, pozicioni juaj i punës është suprimuar”.

Ankuesi për shkak të detyrës së tij si Investigator i Sigurisë, gjatë takimit i ka bërë me dije punëdhënësit mbi dyshimet e tij të arsyeshme për veprimet korruptive të personave të punësuar pranë punëdhënësit dhe se zgjidhja e kontratës së punës, është sanksion i pajustificuar ndaj tij.

Dyshimet e tij për aktivitet korruptiv të punonjësve të Shoqërisë Bankers, ankuesi ia ka parashtruar punëdhënësit edhe më parë, siç vërtetohet edhe me korrespondencën me e-maillet bashkëngjitur ankimit. Referuar nenit 10/1 të Kodit të Punës “Mbrojtja për punonjësit që denoncojnë korrupsionin”, punëdhënësi ka detyrimin të provojë që ky sanksion nuk ka qenë për shkak të denoncimeve që ka bërë ankuesi, për aktet korruptive të punonjësve të Shoqërisë Bankers.

Po ashtu, punëdhënësi nuk ka treguar se cilat ishin nevojat e shoqërisë dhe shkaqet për të punësuar një investigator të sigurisë në datë 15.07.2020 dhe cilat ishin arsyet dhe shkaqet përse shoqëria duhej të ristrukturohej dhe të hiqte nga struktura pikërisht këtë pozicion, në një periudhë kur në krye të shoqërisë nuk kishte një CEO, por ishte një periudhë vakumi në drejtimin e lartë të Shoqërisë Bankers Petroleum Albania LTD. Ankuesi është kontaktuar dhe kërkuar të punësohej si Investigator i Sigurisë pranë departamentit të sigurisë nga vetë CEO i mëparshëm i kompanisë Bankers, z. G.S. Punësimi i ankuesit është kryer duke u bazuar në aftësitë e tij për të zbuluar veprimet korruptive të personave të punësuar pranë shoqërisë Bankers.

Në datë 30.10.2020, Shoqëria Bankers ka bërë ndryshime në regjistrin tregtar dhe ka vendosur të ndryshojë përfaqësuesin e saj ligjor, duke zëvendësuar z. G.S me z. Q.F”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar

në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së dhe parashtrimeve të tij, Komisioneri konstaton se:

- Ankuesi me shkresën nr. 1013/2, datë 13.11.2020 “Njoftim për zgjidhje përfundimtare të kontratës së punës”, është njoftuar nga punëdhënësi për zgjidhjen përfundimtare të kontratës së punës.
- Subjekti ankues në formularin e ankesës ka deklaruar se ka marrë dijëni për diskriminimin e pretenduar në datë 13.11.2020.
- Në kontekst të sa më sipër, **ankuesi ka marrë dijëni për zgjidhjen e kontratës së punës, në datë 13.11.2020. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datë 18.04.2023**, pra më vonë se dy vite nga marrja dijëni.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijëni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e shtetasit E.H, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi².

² Për analogji shih vendimet nr. 209, datë 30.11.2022 dhe nr. 211, datë 05.12.2022, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 60, datë 18.04.2023, të paraqitur nga z. E.H kundër Shoqërisë Bankers Petroleum Albania LTD, pasi është paraqitur tej afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA